

UDC 316.472.4

Prof. dr. Bashkim SELMANI<sup>1</sup>

**NJERIU SI QENIE NJERËZORE I CILI DREJTON DHUNËN KUNDËR VETES APO TË TJERËVE – PASOJAT E KOHËS APO KOHËZGJATJES SË TRNASACIONIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

**ЧОВЕКОТ КАКО ЧЕВОЧКО СУШТЕСТВО КОЈ УПРАВУВА СО НАСИЛСТВОТО СПРЕМА СЕБЕ ИЛИ СПРЕМА ДРУГИТЕ – ПОСЛЕДИЦИТЕ НА ВРЕМЕТО ИЛИ ВРЕМЕТРАЕЊЕТО НА ТРАНЗИЦИЈАТА ВО РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА**

**MAN AS A HUMAN WHO DIRECTS THE VIOLENCE TO HERSELF AND OTHERS - CONSEQUENCES OF TIME OR LONG TIME OF TRANSITION IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA**

**“Njeriu është ai që është dhe nuk është ai që është”.<sup>2</sup>**

***Abstract***

In support of the history and creation of human society in some level can be ascertained that the man is complicated being, and we in the following will try to concretizing it more in its different views. In science, in a far extent, also in our life we face with the concepts man, individual, personality, individuality, often we give them different meanings. In verily, although close to one another, they have differences between them. During its historical development man has harmonized, socialized, where this side is the key feature of man as human being. It develops as a consciousness in the working process, interpersonal communication, social relationships that develop between people.

**Key word:** history, creation of human society, complicated being, different views, Consciousness, working process.

**1. Njeriu është një qenie e ndërlikuar (konceptet njeri, individ, personalitet, individualitet)**

Në mbështetje të historikut dhe krijimit të shoqërisë njerëzore në një far shkalle mund të konstatohet se njeriu është qenie e ndërlikuar, në vijim do të përpiqemi ta konkretizojmë atë më

---

<sup>1</sup> Profesor universitar, në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Fakulteti Juridik.

<sup>2</sup> Zhan Pol Sartri.

shumë në pamje të ndryshme të saj. Në shkencë, por deri diku edhe në jetë ndeshemi me konceptet njeri, individ, personalitet, individualitet, shpesh atyre u jepen kuptime të ndryshme. Në të vërtetë, megjithëse të afërta me njëri-tjetrin, të ndërthurura e të ndërprera, ata kanë dallime midis tyre. Koncepti njeri ka të bëjë me atributet e kësaj qenieje si natyrore, ashtu edhe shoqërore. Njeriu është “një fëmijë” i natyrës dhe shoqërisë. Njeriu vërtet është një qenie biologjike, por ai dallohet nga të gjitha kafshët tjera, jo vetëm nga disa veçori biologjike e specifike për të si qëndrimi vertikal, ecja drejt, duart të përshtatura për punë, tru shumë kompleks i zhvilluar, por nga prania e vetëdijes, e cila është produkt shoqëror. Gjatë zhvillimit të vet historik ai është harmonizuar, njerizuar, socializuar. Kjo anë përbën tiparin themelor specifik të qenies njerëzore. Ajo zhvillohet si vetëdije në procesin e punës, të komunikimit ndërnyerëz, të marrëdhënieve shoqërore që zhvillohen midis njerëzve. Pikërisht në këtë proces zhvillimi ai afrohet edhe si personalitet.<sup>3</sup>

Po me individ çfarë kuptojmë? Para së gjithash njeriun e gjallë konkret me të gjitha veçoritë individuale fizike e psikike, që e karakterizojnë, pavarësisht nga shkalla e zhvillimit të vetëdijes së tij. Në ndërvarësitë që ekzistojnë midis këtyre dukurive, çdo personalitet është një individ. Por, jo çdo individ mund të japë menjëherë e automatikisht një personalitet. Ta zëmë, fëmija i porsalindur ose një i sëmurë psikik janë individë, por, jo edhe personalitete në kuptimin e mirëfilltë e të plotë të kësaj fjale. Kurse për individualitetin kuptojmë anën e veçantë e specifike të personaliteti, atë çka është origjinale dhe vetjake te një njeri i caktuar, atë çka e dallon, e shquan atë si person nga njerëzit e tjerë. Individualiteti materializohet në punë e në krijimtari. Dukshëm atë mund ta shohim te një racionalizator, të një shpikës, te një artist, te një shkencëtar etj. Individualiteti shpreh portretin psikologjik të bartësit të tij, brendinë e kahjen shoqërore të tij. Shpesh individualiteti shprehet edhe në pamjen e jashtme të njeriut, në anë të ndryshme të saj.<sup>4</sup>

## **1.2. Personaliteti njerëzor nëpërmjet tre “rrathëve” të tij**

Nga ajo që thamë më lartë mund të shprehemi se për të qartësuar edhe më shumë ndërlikueshmërinë njerëzore po përpiqemi ta paraqesim atë edhe në një prerje tjetër, nëpërmjet tre rrathëve. Rrethi i parë është ai aparent, që paraqitet së jashtmi e që shihet. Qëllon që të duket se njeriu me të cilin ke të bësh është i qartë për ty që në pamje të parë. Dhe mund të ndodhë që ashtu të jetë në të vërtetë. Ka tipa që janë ndjeshëm transparentë e të sinqertë, të hapur e të çelur. Kjo u duket edhe në fytyrë, në shikim, në buzëqeshje, në të folur, në mënyrën si të dëgjojnë e si reagojnë, në komunikim. Kjo mund të merret si lëvozhgë. Po, në shkallën e mundshme, kjo shfaqje e jashtme e personalitetit mund të jetë në unitet me thelbin e tij. Mund të ndodhin edhe shmangie nga ky unitet. Një lloj shfaqje e jashtme e tillë edhe mund të gënjejë. Madje edhe të të zhgënjejë. Mundet. Kemi të bëjmë me mospërputhjen midis lëvozhgës dhe thelbit. Rrethi e parë nuk zbulon fillësën e vërtetë të një qenieje njerëzore, të një personaliteti. Ngjan edhe kështu.

---

<sup>3</sup> Hamit Beqja “Edhe engjëlli edhe djalli janë brenda te i gjalli” f. 36-37 “Albinoform” Tiranë, 1995

<sup>4</sup> Po aty, f. 37-38

Kemi të bëjmë me një fillim dyzimi. Sigurisht që kemi të bëjmë me një shfaqje relativisht të theksuar dyzimi. Në rastin konkret, gjithmonë midis lëvozhgës dhe thelbit. Ndërsa te rrethi i dytë, te ai që është më i qenësishëm, edhe më i rëndësishëm e që po e quajmë i vetëdijshëm. Është vetëdija ajo që i jep kahje veprimtarisë së njeriut, e drejton dhe e kontrollon atë. Njeriu është, - së paku në tërësi, si rregull, duhet të jetë- i vetëdijshëm për atë që bën. Ky është tipari themelor që e dallon qenien njerëzore nga të gjitha qeniet e tjera të gjalla, qoftë edhe nga kafsha më e zhvilluar, majmuni. Në mbështetje të asaj që folëm deri tani se ç'është ai që e kemi quajtur si një farë rrethi i tretë që lidhet me dyzimin njerëzor. Ai është nënvetëdija ose subkoshienca. Bëjmë kështu lidhjen midis tre rrathëve "të materializimit" në jetë të personaliteti njerëzor, shfaqjes së jashtme, vetëdijes e nënvetëdijes. Në lidhjet e tyre ka edhe unitet e vijimësi, edhe ndërprerje e kundërshti. Për Frojdin nënvetëdija njerëzore ka një rëndësi kolosale. Ajo është djepi i personalitetit tonë, hambari i përhershëm i tij. Në qoftë se personaliteti njerëzor është një akullnajë e madhe, vetëm maja e aisbergut, pjesa e tij e dukshme është vetëdija, kurse thuajse i tërë aisbergu që ndodhet nën të është nënvetëdija.<sup>5</sup> Në mbështetje të këtij vlerësimi duhet ditur se çfarë ka në këtë hambar të madh të nënvetëdijes njerëzore?

Para së gjithash instinkte nga më të ndryshmet, shtypa e stimuj të fortë që e gllabërojnë njeriun. Nga më variablet, por, gjithmonë joshëse e torturuese, thithëse e rrënimtare. Mbi të gjitha instinkti i dashurisë. Pasi, siç do të kemi rast të përmendim, vetë mendimet e Frojdit për këtë materie të ndërlikuar. Gjithmonë sipas tij, fillimisht, veprimtaria e njeriut udhëhiqet nga instinktet, një dukuri biologjike, që, siç dihet vërehet edhe te kafshët. Shtypat instiktive janë jo vetëm shumë të forta, por edhe me prirje shkatërruese, shpesh tepër destruktive që në vijim ne do të flasim si dukuri të cilat i studion Patologjia sociale si faktorë devijues për vet individin me pasoja për rrethin e tij dhe shoqërinë. Ndryshe mund të konstatojmë se pikërisht kjo është faza me të cilën merret patologjia se si i bëhet këtij shpërthimi fillimisht të papërmbajtur të subkoshiençës njerëzore. Pikërisht atëherë fillon punën koshienca. E përcaktuar nga shoqëria, nga historia dhe traditat e saj, nga qytetërimi aktual, nga kultura dhe edukata e saj etj. Është kjo vetëdije që synon ta kontrollojë, ta drejtojë nënvetëdijen. Në një far mënyre, për aq sa ka fuqi e për aq sa mundet, përpiket ta bëjë "zap" (shprehje popullore). Por, në këtë ndeshje midis tyre, në këtë konflikt njeriu ndrydhet e shtypet, përplasat sa këtej e sa andej, nuk e gjen gjithmonë menjëherë e qartë orientimin, përjeton stresa e trauma psikike, neuroza e psikoza.<sup>6</sup> Nga kjo që thamë më lart del qartë se në një farë mënyre ai është viktimë e këtij konflikti midis nënvetëdijes e vetëdijes. Këtej merr ushqim edhe dyzimi i tij, madje, në një shkallë të caktuar, edhe tjetërsimi. Prandaj për çdo lëndë studimi është me rëndësi që të njohim problemet dhe shqetësimet sociopatologjike që nga faza e parë e paraqitjes dhe etiologjisë së mundshme për të administruar sa me më pakë pasoja të mundshme. Pra, kultura e njohjes së dhe e trajtimit të instiktive njerëzore, të nënvetëdijes, e ndikimit shoqëror kulturor dhe edukativ mbi këtë nënvetëdije, të lidhur me kultivimin e çatisë së personalitetit njerëzor, vetëdijes së mirëfilltë. Sa më e fuqishme

---

<sup>5</sup> Po aty, f. 56-57

<sup>6</sup> Po aty, f. 57-58.

që të jetë situata e kontrollit të vetëdijes njerëzore aq më pak mund të ndodhin shqetësime dhe devijime të mundshme për vet faktorin njeri.

### **1.3. Vdekja dhe shtrati i vdekjes**

Koha që po kalojmë është e përmbushur plotë strese dhe depresione që ndikojnë gjithmonë për dyzimin e personalitetit njerëzor dhe për një ko incidencë në favor të personalitetit njerëzor, shpesh në komunikime të rëndomta, depresionin e njëjtësojnë me çdo sëmundje psikike. Prandaj lind pyetja se mund njeriu të ketë neurozë, psikozë, shfaqje sëmundjesh të tjera psikike, ose ndryshe tamam depresion, thuajse në të gjitha rastet njeriu ndjehet i tensionuar dhe mbjell tensionim edhe ndaj të tjerëve rrethit dhe shoqërisë që në të shumtën e rasteve përfundojnë në sëmundje patologjike. Kjo nënkupton se po flasim me një gjuhë më afër shkencës së psikiatrisë, nuk është e saktë se themi kështu.<sup>7</sup> Depresionin, është fjala për atë bipolar, ndryshe, më saktë, më shkencërisht, e quajnë *psikozë maniako-depresive*.

### **1.4. Suicidet dhe parasiucidet si pasojë e depresionit**

Suicidet dhe parasiucidet si pasojë e depresionit kanë një rol të veçantë për të studiuar depresionin si pasojë e vdekjes, dhunë e ushtruar nga vetvetja apo ndaj të tjerëve. Parë në këtë prizëm ekzistojnë sëmundja ka dy anë; të parën atë maniakale (hipomani) në përkthim nënkupton mani e vogël, e ulët. Dhe në anën tjetër; atë deprimuese, ose pikërisht depressive, më tepër në kuptimin gjuhësor se sa shkencor të kësaj fjale. Pra kemi të bëjmë me dy pole të kundërta, që jetojnë në një trup të vetëm, në “një ind”, me dy tejskaje të këtij trupi. Prandaj, këto lloj depresioni-pasi besojmë se e kuptojmë se ka disa tipa depresionesh dhe i quajnë si depresion bipolar. Zakonisht depresionin e ndajnë në endogjen dhe ekzogjen, pra me burime kryesisht ose tërësisht të brendshëm, dhe me burime kryesisht të jashtme, të mjedisit, kuptohet më shumë të atij shoqëror, pa përjashtuar edhe atë natyror. Në këto ndarje nuk mund të kërkohet nuk mund të kërkohet pastërti absolute, pasi ka momente përzjerje, alternimi. Në mbështetje të psikiatrisë tonë ka anuar më shumë, - e ndoshta anojnë ende- që të sëmurët me depresion i kanë kualifikuar më shumë endogjene. Kjo nënkupton se depresioni me burim të jashtëm, do të thotë i përcaktuar ndikimi i faktorëve shoqëror. Mirëpo kuptimit të “socializimit” kjo nuk i shkonte aq për shtati.

Ndryshe qëndron puna me depresionin endogjen. Është fjala për burime të brendshme; fiziologjike, biokimike, hormonale, endokrine, nervore, neuropsikike. Dhe për faktorë të tillë trashëgimia, infeksionet në shtatzëni, infeksionet gjatë fëmijërisë, infeksione gjatë gjithë jetës, lodhje e ngarkesa të papërbalueshme nga organizimi, avitaminoza etj. Të gjitha këto faktorë që përmendëm mund të bëhen shtrat për depresionin endogjen. Por, siç kuptohet, shkaqet e tij, aq më tepër përthyerja individuale e tyre, me gjendjen e sotme të mjekësisë, veçmas të psikiatrisë, është vështirë të njihen. Parë në këtë prizëm, mund të konstatojmë se të menduarit shqiptar njihet

---

<sup>7</sup> Le të thërrasim në ndihmë një aforizëm shqiptarë, i cili në planin që po diskutojmë është jashtëzakonisht karakteristik ku thuhet “Edhe engjëlli edhe djalli janë brenda te i gjalli”.

me një gjaknxehtësi e cila ka pasoja të rënda në shoqërinë shqiptare, por, fatkeqësisht deri më tani jo aq e hulumtuar dhe studiuar nga seç e meriton një studim i tillë për të parandaluar që mos të trashëgohet tek gjeneratat e reja.

Në vazhdimësi do të flasim dhe shtjellojmë për pasojat e gjaknxehtësisë si pasojë dhe shakatarë etiologjikë të shumë vrasjeve-vetëvrasjeve dhe pasojave të tjera depresive që shkaktojnë çrregullime socio-patologjike sa që arrihet deri në aktin tragjik të vrasjeve dhe vetëvrasjeve (parasuicideve)<sup>8</sup>.

Po të mbështetemi me vëmendje në përditshmërinë e jetës njerëzore do të konstatojmë se përcaktimet jetësore i vlerësojnë disa praktika që në filozofinë praktike jetësore kërkojnë përgjigjen e pyetjes ç’duhet të bëjmë për të administruar jetën si të tillë me të gjitha shqetësimet dhe të mirat që na nxjerrë jeta e përditshme dhe një komunikim më të ngritur për të pasur një jetë më të përgatitur për t’i luftuar sfidat e jetës dhe jo për t’u viktimizuar përballë kësaj rruge e njohur si jeta bashkëkohore demokratike?

Kur flasim për administrimin e jetës së përgjithshme shoqërore sidomos për etikën dhe verimin e njeriut në shoqëri merren për bazë proceset e dy mendimeve, dhe njeriu për të perceptuar vlerat e tij, qëllimet e tij, idealet e tij kualitet e së mirës dhe së keqes por, ky është momenti kur njeriu humb sensin për prioritetet dhe shfrytëzimin e mundësisë për veprim të drejtë apo në veprim jo të drejtë. Sa i kushtojmë rëndësi të mirës dhe të së keqes njerëzore në shoqëri. Në botën bashkëkohore janë paraqitur shumë shkenca të kësaj natyre dhe në këtë mënyrë u zhvilluan dhe disa disiplina të ndryshme etike, siç janë historia e etikës, etika teorike, etika kriminalistike, etika mediale, etika praktike, etika profesionale e cila merret me detyra dhe norma morale konkrete të profesionale të profesioneve të ndryshme njerëzore siç janë etika e juristëve, gazetarëve, mjekëve ekonomistëve zejtarëve e të tjera.

Parë në këtë prizëm, dhe jetën që po jetojmë në një sistem i cili identifikohet pikërisht me një tranzicion të stërgjatur, të ngarkuar me shumë padrejtësi e cila në vazhdimësi bën thyerjen edhe të atyre pak relikteve të së kaluarës morale. Prandaj parashtrohet pyetje se kush mban llogari për të gjitha këto shqetësime të kohës së fundit e njohur si shoqëri bashkëkohore, demokratike dhe shumë nocione të bukura në aspektin formal por, në brendi realisht mbartë me vete një cilësi e njohur “vrap pas një jete ideale e përmbushur me lukset e kohës”, ndërsa mospërputhja manifestohet pikërisht në momentin, mbi atë se çfarë duhet të jetë realiteti shoqëror. Pikërisht në këtë rrugëtim jetësor njerëzit humbin anët e veprimit dhe përballen me dy qasje kategoriale që njihet si vetëkontrolli individual ndaj asaj që ne duhet të marrim veprime të caktuara për të zgjidhur një çështje të caktuar. E para, njeriu në vete përmban disa karakteristika të veçanta që herë i përdorë në mënyrë të drejtë e herë në mënyrë jo të drejtë. E para njihet si sjellje pozitive në shoqëri ndërsa e dyta njihet si sjellje negative.

Tek sjelljet negative identifikohen edhe dy nën kategori që në jetën e përditshme njihen dhe atë shkencore njihen si sjellje e dëmshme drejtuar nga të tjerët dhe e dyta drejtuar nga

---

<sup>8</sup> Bashkim Dr. Selmani “Masat dhe aktivitetet që duhet të ndërmerren shtetit për parandalimin dhe pengimin e vetëvrasjeve në Republikën e Maqedonisë nga viti 1999-2009”, f. 124-201.

vetvetja. Sjelljet negative të orientuara kah dëmi personal më së shpeshti janë të drejtuara kundër vetes, mirëpo shpesh edhe kundër të afërmve. Që më vonë marrin përmasa më të ndërlikuara nëse nuk parandalohet qoftë nga familja apo nga shoqëria dhe vetë shteti dhe dalja nga këto korniza normale të një individi përshkallëzohet në dukuri sociopatologjike ku bëjnë pjesë; vetëvrasja, bixhozi, alkoolizmi, narkomania, prostitucioni etj. Ndërsa sjelljet e drejtuara kah dobia personale më së shpeshti të drejtuara kundër të tjerëve dhe të afërmve të tij, bëjnë pjesë kriminaliteti, vrasjet, dhunimet, vjedhjet, djegiet, grabitjet, kusaria, mashtrimet etj. Parë në këtë prizëm, këto verime e përcjellin çdo njeri në shoqëri, por më vonë sjelljet e këtylla karakterizohen si sjellje ose devijim shoqëror ku përfshinë dy sfera të hulumtimit sociologjik, si sjellje devijuese dhe dezorganizime shoqërore. Sjelljet devijuese dhe dezorganizimi shoqëror janë dy lloje të dukurive të cilat, edhe pse mes vete janë të lidhura, edhe konceptualisht edhe empirikisht dallohen. Ndërlidhja dhe kushtëzimi i tyre reciprok del apo buron nga natyra dialektike e marrëdhënies së individit dhe shoqërisë. Për studimin e këtij fenomeni shoqëror në psikologjinë shqiptare në mbështetje të studimit dhe anketimit të qytetarëve që kam parashtruar në një hulumtim shkencor “Gjaknxehësia si faktor kryesor për kryerjen e shumë veprave penale me motive të ulta tek nacionaliteti shqiptar në Republikën e Maqedonisë .” ku janë anketuar persona që kanë kryer vepra penale në Republikën e Maqedonisë nga periudha 1970-2009.

Si rezultat i gjaknxehësisë janë edhe disa faktorë, si stresi, emocione të ndryshme të pasigurisë së përgjithshme shoqërore dhe individuale, shprehje shpesh herë të pa pranuar nga publiku dhe shoqëria bashkëkohore, komunikimi i keq si në familje ashtu edhe në rrethin ku jetojmë, një kategori e qytetarëve shqiptarë çdo fjali komunikim e fillojnë dhe mbarojnë me fjalë të ndyta që e njëjta pasojë reflektohet edhe tek fëmijët e tyre që më vonë përmban edhe përmasa më të mëdha shoqërore. Ky pra, është edhe synimi i këtij punimi shkencor që të japë sinjalizimin e ngritjes së dioptrisë së studimit dhe hulumtimit shkencor ndaj këtij fenomeni dhe të synohet në parandalimin e dhunës drejtuar vetvetes dhe të tjerëve. Fatkeqësisht një kategori e njerëzve tanë viktimizohen me pa të drejtë, por thjesht si një pasojë e daljes nga qasja e vetëkontrollit të çastit por, me pasoja të mëdha për jetën e tyre dhe të afërmve të tij. Si përfundim mund të konstatojmë se ekzistojnë dilema shkencore juridike, sociologji-patologjike që flasim për një indikator të kësaj natyre shqetësuese me pasoja penale dhe vet-viktimizim në nga mos dalja ose zgjidhja nga ankthet që mbartë me vete koha që po kalojmë e përmbushur përplot me strese, emocione të ndryshme të pasigurisë jetësore ekonomike, sociale dhe ato shoqërore në përgjithësi, prandaj ky fenomen me pasoja të pa pranuar, duhet para së gjithash të studiohet pikërisht nga vetë hulumtuesit shqiptarë dhe ekspertë të ndryshëm ndërkombëtarë.

**Ideja e vërtet që njeh ekzistencën e një ideje  
tjetër është diçka e mirënjohur<sup>9</sup>**

---

<sup>9</sup> Richard Jeffries, autor anglez.

## **Përfundimi dhe roli mjekoligjor**

Mjeku dhe juristi janë ndër aktorët kryesorë, të cilët, në rrethana të ndryshme, thirren për të vënë në lëvizje rolin e tyre profesional brenda përbrenda “shtratit të vdekjes”. I pari ka si detyrë të tij parësore diagnostikimin e vdekjes dhe shkakun që bëri të pashmangshme ardhjen e saj, ndërsa i dyti të hetojë dhe përcaktojë natyrën juridike të vdekjes. Për çdo person që mendohet se ka vdekur, mjeku thirret për të kryer tri detyra: të përcaktojë nëse vdekja ka ndodhur me të vërtetë, të njihet me rrethanat mjekësore të vdekjes dhe të bëjë një këqyrje të jashtme të kufomës, për të nxjerrë në pah nëse kemi të bëjmë me një vdekje me, apo pa dhunë. Në raste të dyshimta, atij i duhet të bëjë kallëzimin në organin e ndjekjes penale dhe rasti konsiderohet mjeko-ligjor, nëse ka të qartë shkakun e vdekjes, mjekut i duhet të plotësojë skedën e vdekjes.

Vërtetimi mjekësor i shkakut të vdekjes dokumentohet nëpërmjet mbushjes me shkrim të një formular të quajtur Skeda e vdekjes, rubrikat e të cilës janë të njësuar sipas një klasifikimi ndërkombëtar të miratuar nga OBSH (Organizata botërore e shëndetësisë) për të gjitha llojet e sëmundjeve dhe traumave. Skeda e vdekjes ka rëndësi në shumë drejtime. Përcaktimi i saktë i momentit të vdekjes ka rëndësi të posaçme në të drejtën civile, pasi me të lidhet çelja e trashëgimisë dhe përcaktohet rrethi i personave që të përfitojnë të drejta trashëgimie e të ndjerit *dekujusi*. Mënyra e vdekjes është forma e ardhjes së shkakut të vdekjes, që përcakton edhe natyrën e saj dhe ka rëndësi nga pikëpamja juridike, për të përcaktuar nëse ka vend ose jot ë një procesi gjyqësor.

Eksperti mjekoligjor, në përcaktimin e lidhjeve të dëmtimeve të jashtme me shkakun e vdekjes bazohet na shkallën e rëndësisë të këtyre dëmtimeve në raport me vlerësimin e veçorive të dëmtimeve të brendshme anatomopatologjike, që vihen në dukje gjatë autopsisë, si dhe rrethanat e ndodhisë së vdekjes, prandaj sot, në praktikën gjyqësore kemi shumë raste kur vrasjet dhe vetëvrasjet ngatërrohen me keqpërdorime të mjekësisë ligjore në praktikën gjyqësore në Republikën e Maqedonisë me ose pa dashje që fatkeqësisht këtë përgjegjësi e mbulojnë ekspertët mjekoligjor në procedurat gjyqësore, për të dëshmuar arsyet e vdekjes.

## **BIBLIOGRAFIA**

1. Analiza juridike e konceptit të veprës penale të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes, OSBE, Poliesterdej, Shkup, 2012;
2. Rregullimi i mediave, studim komparativ, Dejvid Goldbert, Toni Proser dhe Stefan Berhulst, Ars Lamina, Shkup;
3. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Stiven Grir, Prosvetno Dello, Shkup, 2009;

4. Liria e shprehjes dhe demokracia, Sllagjana Dimishkova, Veçer Press SHPK Shkup, Cetis print, Shkup, 2008,
5. Freedom of the Media, Freedom of Expression, Free Flow of Information; Conference on Security and Co-operation in Europe (CSCE) and Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE) 1975-2012, 2nd Edition.- Vienna: OSCE Representative on Freedom of the Media, 2013, 56 pp.
6. Manuali për të drejtën evropiane për mosdiskriminim, Agjencia për të Drejtat Fundamentale të Bashkimit Evropian, Këshilli i Evropës, 2010.
7. Hyrje në të drejtën evropiane, Desche Stiftung fur Internationale Rechtliche Zusammenarbeit E.V., Magor, SHPK, Shkup.
8. Zbatimi i së Drejtës së Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë në periudhën para anëtarësimit në BE, Projekt Hulumtues Nacional Shkencor, Fakulteti i Drejtësisë, UCEM, BoroGrafika, Shkup;
9. Gjuha e urrejtjes në mediat bullgare dhe maqedonase: shembuj, shkaqe, zgjidhje, Media development center;
10. Analiza juridike e konceptit të veprës penale të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes OSBE, Poliesterdej, Shkup, 2012;
11. Štefan Rus Mol, Ana Jugoslava Zagorac Keršer, Novinarstvo, Clio, 2005;
12. The Camden Principles on Freedom of Expression and Equality, April, 2009;
13. Udhëzues praktik për kriteret e pranueshmërisë, Magor SHPK, Shkup 2013;
14. Aktgjykime, vendime në lidhje me gjuhën e urrejtjes nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (mbështetur nga OSBE), Skenpoint, Shkup 2012;
15. Lawrence, Frederick M., Punishing Hate: Bias Crimes under American Law, Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts, 1999.
16. Hate Crime Laws: A Practical Guide, Published by ODIHR, Warsaw, Poland, 2009;
17. Preventing and Responding to Hate Crimes: A Resource guide for NGOs in the OSCE region, OSCE/ODIHR, 2009;
18. Richard Delgado, “Words that wound: A tort action for racial insults, epithets, 46 Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes and name calling” In Mari J. Matsuda, C.R. Lawrence III, R. Delgado, & K. W. Crenshaw (Eds.), Words that wound: Critical race theory, assaultive speech, and the First Amendment, Westview Press, Boulder, CO, 1993;
19. Hate Crime Laws: A Practical Guide, OSCE, Published by ODIHR, Warsaw, Poland, 2009;
20. Barbora Bukovská (Prezantim), Konferencë rajonale për krim nga urrejtja dhe gjuha e urrejtjes OSBE, RM, viti 2012;

## **Dokumente ndërkombëtare**

-  Deklarata e Pavarësisë e SHBA, 1776;



- ✚ Deklarata Franceze e Pavarësisë, 1789 ;
- ✚ Deklarata për të Drejtat e Shtetit të Virxhinisë, 1776;
- ✚ Kushtetuta e SHBA, 1791;
- ✚ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948;
- ✚ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike 1966;
- ✚ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 1950;
- ✚ Karta Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 2000;
- ✚ Deklarata Amerikane për të Drejtat dhe Detyrimet e Njeriut, 1948;
- ✚ Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut, 1969;
- ✚ Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve, 1981;
- ✚ Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor të OKB, 1965;
- ✚ Vendimi Kornizë për Vepra Penale Raciste dhe Ksenofobike të Bashkimit Evropian, 2008;
- ✚ Konventa për Ndjekjen e Akteve të Natyrës Raciste dhe Ksenofobike të Kryera përmes Sistemeve Kompjuterike (Konventa për Krimin në Fushën e Kibernetikës), 2001 dhe Protokolli Plotësues ndaj Konventës, 2003;
- ✚ Deklarata për Parimet Themelore për Kontributin e Mediave në Përforcimin e Paqes dhe Mirëkuptimin Ndërkombëtar, për Avancimin e të Drejtave të Njeriut dhe Luftimin me Racizmin, Aparteidin dhe Nxitjen e Luftës, UNESKO, 1978;